




GRATË DHE COVID-19 TREGIMET QË KANË RËNDËSI

Garë për fotografi
dhe tregime



European
Union
Kosovo



EUROPE
HOUSE

GRATË DHE COVID-19 TREGIMET QË KANË RËNDËSI

Garë për fotografi
dhe tregime



Parathënie	4
Editorial	6
Fituesit e garës “Covid-19: Gratë dhe tregimet e tyre”	7
Vendi i parë	8
Arlinda Murtezi	8
Vendi i dytë	10
Adonjeta Zymberi	10
Vendi i tretë	12
Dragana Millosavleviq	12
Vendi i tretë	14
Orhidea Reka Shehu	14
Tregime të tjera nga gara	16
Albulenë Krashiqi	16
Albulena Uka	17
Arbresh.info	18
Arta Ibishi Çitaku	19
Bardha Sadrija	20
Bojana Miniq	21
Brankica Timotijeviq	22
Ermira Kraja	23
Gentiana Pallaska	24
Tregimi për nënën e saj, nga Shehida Miftari	25
Tregimi për nënë Fahrijen, nga Shyhrete Kadriu	26
Sunçica Andrejeviq	27
Tregimi për Teuta Gashin, nga Enis Puka	28
Tregimi për Xhyla Hazirin, nga Ardiana Musa	29
OJQ Zensko Pravo (Të drejtat e grave)	30
Gra të tjera të jashtëzakonshme gjatë pandemisë	31
...të cilat nuk ishin pjesë e garës, por veprimet e të cilave gjatë pandemisë janë shembull i mirë për nismat dhe leadershipin e grave	31
Elza Ramadani	32
...dhe si kafshët endacake nuk u harruan gjatë pandemisë	32
Flutra Zymi	33
...dhe sa të rëndësishëm janë zërat e aktivizimit gjatë kohërave të vështira	33
Mrika Nikaj	34
...dhe si gruaja më e re në botë që u ngjiti në Shtatë Majat	34
më të larta e ri-gjeti veten për t'u mbajtur në formë	34
Dr. Donjeta Pllana, Dr. Pranvera Abazi dhe Dr. Zana Kaçaniku	35
...dhe si tri gra menaxhuan testimin në Laboratorin e Diagnostikimit Molekular	35
Mimoza Kusari	36
...dhe iniciativa e saj për t'i mbështetur bizneset e udhëhequra nga gratë që janë prekur nga Covid-19	36
Strehimoret për dhunën në familje dhe mbi bazë gjinore në Kosovë	38
...dhe si operuan ato pa ndërprerje për pranimin dhe mbështetjen e të mbijetuarave gjatë pandemisë	38
Ekipi redaktorial	40

Parathënie



Përderisa Covid-19 e tronditi tërë shoqërinë, më të cenueshmit u prekën më rëndë. Në ditët e para, kur filloi mbyllja, analiza e shpejtë e riskut në mbarë botën parashikoi se gratë do të preken në mënyrë më serioze sesa burrat nga pandemia. Më shumë dhunë dhe më pak mundësi për ta raportuar atë, humbje të vendeve të punës dhe më pak mbrojtje sociale, më shumë detyrime familjare, më shumë kujdes për fëmijët, të

moshuarit dhe të sëmurët si dhe më shumë gra si reagues të parë, në rrezik për shëndetin dhe jetën e tyre.

Është e qartë se pandemia mund të paraqesë një hap prapa në avancimin e të drejtave të grave të arritura në dekadat e fundit. Ne e morëm këtë parasysh në kohën e ridrejtimit të resurseve për zbutjen e pasojave të Covid-19, duke dedikuar fonde për lehtësimin e pasojave të Covid-19

posaçërisht për gratë.

Gjithashtu dëshiroam që ta ngrehim vetëdijen për këtë çështje. Ajo që ndodh me gratë, ka të bëjë me tërë shoqërinë, dhe të gjithë duhet ta dinë dhe të përfshihen. Dhe a ka mënyrë më të mirë për të shpërfaqur se si gratë në Kosovë u prekën nga pandemia, sesa nëse i lëmë vetë gratë që t'i tregojnë tregimet e tyre?

Gara nuk ishte vetëm garë për tregime, por edhe garë fotografie. Juria e mori atë parasysh në kohën e marrjes së vendimit. Dhe nuk ishte lehtë sepse më shumë se 80 pjesëmarrës hynë në garë. Secili prej këtyre tregimeve është i fuqishëm, i rëndësishëm ose prekës dhe çdo fotografi është e bukur ose përfaqësuese. Disa janë tregime të lumtura, disa pikëlluese. Në përgjithësi, të gjitha tregojnë qëndrueshmërinë e grave në Kosovë në menaxhimin e sfidave që përfaqëson Covid-19.

Në mesin e tyre, katër tregime dolën të parat dhe unë u ndava atyre çmimet në një ceremoni që u zhvillua në Prishtinë në nëntor 2020. Historitë e foto-tregimeve të Arlindës, Adonjetës, Jovanës dhe Orhideas janë një shembull përfaqësues i të gjitha atyre që hynë në garë: shndërrimi i pikëllimit në lumturi, shfrytëzimi i krijimtarisë për t'i vlerësuar gjërat që ne i marrim si të mirëqena, si familja, artet dhe natyra; punë të shumta në të njëjtën kohë, përtej shërbimit dhe kontributit për komunitetet e tyre, madje duke vënë jetën dhe shëndetin e tyre në rrezik. Ky publikim flet për tregimet dhe fotografitë e tyre dhe

disa të tjerave. Ai gjithashtu paraqet gra që kanë punuar për mirëqenien e burrave dhe grave në Kosovë në mënyrë të jashtëzakonshme gjatë periudhës së Covid-19.

Shpresoj se do ta shijoni!

Ambasadori Tomas Szunyog,
Shef i Zyrës së BE-së/
Përfaqësuesi special i BE-së

**Në procesin e ridrejtimin të fondeve IPA 19 në programe si përgjigje ndaj krizës me COVID-19 (BE për Qëndrueshmëri, Mbështetje Buxhetore dhe BE për mbrojtje sociale), Zyra e BE në Kosovë i kushtoi vëmendje të madhe barazisë gjinore dhe u përqendrua në mënyrë të konsiderueshme në nevojat e grave dhe të vajzave. Zyra e BE/EUSR konsultoi shtetet anëtare të BE-së, EULEX-in, disa donatorë, partnerë shumëpalësh si UNWomen, agjensi të tjera të KB dhe Bankën Botërore. Institucionet e Kosovës si Zyra e Kryeministrit, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Integritetit Evropian dhe Ministria e Punëve të Jashtme gjithashtu janë konsultuar. Shoqëria civile e përfaqësuar nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGGK) kontribuoi në mënyrë thelbësore. Personi kryesor i brendshëm i BE-së dhe këshilltari për çështje gjinore kanë qenë plotësisht të përfshirë në proces. Si rezultat, të gjitha projektet u miratuan me të paktën një objektiv kryesor që synonte barazinë gjinore ose fuqizimin e grave.*

Editorial

2020 na dëshmoi të gjithëve se pa marrë parasysh planet dhe ëndrrat që kemi, nganjëherë gjërat marrin një kthesë tjetër dhe ne do të duhet të përshtatemi.

Gratë në tërë botën është dashur të sakrifikojnë shumë këtë vit, duke pasur parasysh situatën me virusin dhe ndryshimin e shpejtë që kemi pasur të gjithë në jetën tonë. Në vitin 2020, ne u përballëm me të paimagjinueshmen, të pakuptueshmen, të padukshmen dhe nuk kishim zgjidhje: na u privuan kaq shumë gjëra dhe në kaq shumë nivele, megjithatë e gjetëm veten me fat që ishim gjallë dhe mësuam se liria kurrë nuk mundet të merret si e mirëqenë.

Duke qenë të sigurt për këtë, Shtëpia e Evropës në Kosovë, së bashku me kolegët tanë të mrekullueshëm nga Zyra e BE-së në Kosovë/EUSR, lansuan garën e fotografisë 'Covid-19: Gratë dhe Covid' dhe ftuan gratë dhe vajzat e të gjitha moshave dhe kombësive që jetojnë në Kosovë që t'i dërgojnë fotot dhe tregimet e tyre më të mira për ditët e para të ngujimit. I pranuar rreth 100 parashtrime nga gratë të cilat ishin krijuese, kryesisht duke qëndruar në shtëpi ose jashtë në natyrë, duke u marrë me aktivitete të ndryshme që shpesh duken shumë larg nesh. Në vitin 2020, gratë dhe burrat, të gjithë ndanë pak kohë për të reflektuar dhe duke u shëruar nga

dinamika dërmuese e jetës, dhe të gjithë zbuluam se disa gjëra brenda nesh kanë heshtur për kaq shumë kohë, dhe ne u lidhëm përsëri me to.

Rreth 20 parashtrësja janë hedhur në këtë botim dhe ju mund të udhëtoni në kohë dhe në vende të ndryshme dhe të zbuloni se çka bënin gratë në Kosovë gjatë ngujimit dhe pandemisë. Tre çmime ishin paraparë. Një bord jurie përzgjedhi katër gra fituese, pasi që dy nga to morën numër të barabartë pikësh dhe ndan vendin e tretë. Emrat e tyre janë: Arlinda Murtezi, Adonjeta Zymberi, Dragana Milosavljevic, Orhidea Shehu.

Atyre iu ndanë kupona shpërblimesh në një ceremoni të mbajtur me 26 nëntor 2020 në Shtëpinë e Evropës, dhe të kryesuar nga ambasadori Szunyog,. Për shkak të kufizimeve nga Covid-19, në ceremoni mund të merrnin pjesë vetëm një numër i kufizuar njerëzish.

Gjithashtu ne kemi përfshirë edhe gra dhe iniciative të tjera sociale të fuqishme gjatë pandemisë, si dokumentim i jetës gjatë vitit 2020 në Kosovë.

Bashkimi Evropian në Kosovë e njeh fuqinë e grave gjatë periudhave të papara si këto, dhe e përkrahë fuqimisht çdo krijim apo origjinalitet që vjen prej tyre. Kjo garë e fotografisë është shumë më tepër sesa një garë: është mirënjohje e luftës së grave gjatë këtyre muajve të fundit, duke qenë forca thelbësore e familjes, komunitetit dhe e shoqërisë kosovare.

Fituesit e garës

“Covid-19: Gratë dhe tregimet e tyre”



“Është e qartë se me të gjitha kufizimet në lëvizje, gratë janë ato që janë më të cenuara dhe të prekura – në familje, por edhe në jetën shoqërore dhe ekonomike. Pra, ishte e qartë për ne se duhej të bënim diçka specifike për gratë. Prandaj ne vendosëm jo vetëm të financonim aktivitete të ndryshme por edhe të

bënim këtë garë dhe të kishim një demonstrim publik të mbështetjes sonë për gratë.”

Ekipi redaktorial:

Arbër Selmani, Ylli Tafarshiku,
Reyes Charle Cuellar, Maria
Berishaj-Sylejmani, Erëza Vela,
Vedat Shehu

Ambasadori Szunyog



“Unë jam Arlinda Murtezi, nënë e pesë fëmijëve, jetoj në Fushë Kosovë. Unë kujdesem vetë për fëmijët e mi dhe fitoj pak nga shitja e punimeve punëdore përmes një biznesi që e kam hapur.

Kur filloi pandemia, nuk kam pasë mundësi me i shitë punimet e mia. Meqë kam aftësi për rrobaqepësi, kam kuptu që do të ishte mirë me i ndihmu komunitetit tim me qepjen e maskave të ripërdorshme. Dikush më sugjeroi me i shitë ato, por qysh me u bo unë e



pasun kur fqinjët e mi sëmuren? I kam shpërndarë këto maska falas nëpër lagjen time. Jam krenare që bëra diçka për njerëzimin.

Me vullnet e bëj këtë punë dhe më vjen mirë që rastet e COVID-19 nuk janë përhapur në lagjen time. Unë kësisoj kam kontribuar në shëndetin e fqinjëve të mi. Gjithashtu më vjen mirë që kam pasur mundësi t'i mësoj edhe gratë tjera në qepje të maskave”.



Vendi i parë

Arlinda Murtezi



Vendi i dytë

Adonjeta Zymeri





“Në kohën kur bota u mbyll dhe të gjithë ndryshuan mënyrën e jetesës, kur njerëzimi u ngujua për disa muaj brenda shtëpive të tyre, u munduam të njohim më mirë vetën dhe ata që na rrethojnë derisa u përballëm me vështirësi për të tejkaluar këto ditë izolimi.

Përderisa njerëzimi përballej dhe vazhdon të përballët me pandeminë, natyra triumfoi në këtë mes, dhe ishte në gjendje të frymoj sërish. Dhe kjo ndërlidhje, mes heshtjes së rrugëve dhe lulëzimit të natyrës më ka inspiruar të krijoj këtë maskë të

mbushur me natyrë, që në të njëjtën kohë ka edhe mesazhin e fuqishëm se e ardhmja lulëzon edhe në kohë të vështira. Këto lule janë mbledhur në Butovc dhe kanë krijuar këtë maskë të karantinës sime, të cilën e kam fiksuar nëpërmjet fotografisë, e që do të jetë kujtim edhe për djalin tim Yll Dritin, me të cilin përkundër mbajtjes së orarit të punës në rrethana shtëpie, arrita të kalojë një kohë shumë kualitative që në rrethana të dinamikës së jetës sime e kam shumë të pamundur.

Ne frymojmë me natyrën përderisa kujdesemi për vetën dhe të tjerët”!

"Besoj se situata në lidhje me virusin COVID-19 na ka rënduar të gjithëve. E ndjeva mbi supe të mia ngase jam nënë e tre fëmijëve, infermiere dhe gjithashtu drejtoj një kompani private "Miris jutra" ku shes lloje të ndryshme të ëmbëlsirave. Si infermiere, pashë fytyrat e frikësuara të pacientëve, që në fillim nuk dinin si të ballafaqoheshin me këtë situatë të paplanifikuar. Tek ata vërejta një dëshirë për të luftuar, dhe ajo dëshirë ishte veçanërisht e shprehur tek kolegët e mi, mjekët dhe infermierët. Ne me të vërtetë dhamë gjithçka nga vetja ta rrënjosim tek njerëzit besimin dhe shpresën se kjo do të kalojë shpejt, por përsëri duke i ftuar për përgjegjësinë e respektimit të masave epidemiologjike.

Pas gjithë asaj pune të vështirë, kthehesha në shtëpi ku më priste puna në furrën time të vogël. Kjo ishte padyshim një nga mënyrat e mia për t'i bërë njerëzit të lumtur në këto kohë të vështira.

Shpresoj që përmes rolit të nënës, infermieres dhe udhëheqëses së një kompanie të vogël, të kem kontribuar që njerëzit të ndihen më mirë gjatë kësaj situatë të vështirë, e cila shpresojmë se do të kalojë shpejt".





Vendi i tretë

Dragana Millosavleviq



Vendi i tretë

Orhidea Reka Shehu





“Të jesh nënë është bekim nga Zoti, por edhe një përgjegjësi e madhe. Jam nënë e tre fëmijëve. Përvoja gjatë pandemisë ishte një prej më të çuditshmeve në jetën time. Punoj si infermiere në sektorin privat, ndërsa burri im punon në sektorin publik, dhe të dy jemi në vijën e parë të frontit. Bashkë me një kolege timen, e pamë të nevojshme të nisim një iniciativë rreth dhurimit të gjakut, meqë shumë njerëz gjatë kësaj kohe patën nevojë urgjente për gjak. Interesimi ishte më i vogël, shkaku i situatës me COVID-19. Aktiviteti u organizua në mënyrë

krejt profesionale, në koordinim me Qendrën e Transfuzionit të Gjakut në Prishtinë. 51 dhurues të gjakut kontribuan. Situata u përkeqësua më vonë, kur unë dhe burri u testuam pozitiv me COVID. Më kujtohet një natë, kur u zgjova me dhimbje dhe me probleme në frymëmarrje dhe doja të shkoja te dhoma e fëmijëve që t'i përqafoja për herë të fundit, meqë u ndjeva sikur po e jetoja fundin e jetës sime. Këmbët nuk më lejonin të lëvizja. Por e fituam luftën, shpëtuam nga COVID-19. Emocionalisht, ende nuk e kam marrë veten”.

Tregime të tjera nga gara

Më poshtë janë një numër i përzgjedhur i tregimeve nga gratë që kanë hyrë në garë

Albulenë Krasniqi

“Dy fotografitë e mia tregojnë një përballje me dy situata, të përpjekjeve të mia për të ndryshuar atmosferë stresi e paniku, e për t'i shndërruar ato në nivel vullneti e kreativiteti.



Fotoja e parë: ishte data 4 prill 2020, dita kur kisha përfunduar një dollap të librave, koha kur kërkoja mënyra të ndryshme për të larguar monotoninë dhe dëshpërimin. Isha vajzë e vetme në shtëpi, në familje kisha tre vëllezër me gratë dhe fëmijët e tyre, si dhe dy prindërit e mi të moshuar.


Para mbylljes karantinore në shtëpi, e kisha menduar blerjen e një dollapi të librave. Mirëpo, gjatë pandemisë ky mendim kishte ndryshuar, kisha mbledhur disa mjete pune në oborr të shtëpisë, disa që babai im i kishte lënë si të papërdorura, dhe fillova çdo ditë të merrem me nga një pjesë të dollapit. Zgjatja e ditëve për tu marrë me dollapin ishte e qëllimshme, kjo zgjonte tek unë ndjenjën e të dobishmes dhe fuqisë sime për krijim. Me dru, gozhda dhe çekan, një dollap librash.



Në fotografinë e dytë prapa meje duken disa makineri brenda një fabrike. Kjo situatë është gjatë muajit maj, koha kur kisha filluar punën në një fabrikë të letres në fshatin Mirushë.

Situata në familje çdo ditë merrte natyrë tjetër, vëllezërit ishin të papunë, prindërit poashtu, tashmë çdo gjë funksiononte ndryshe. Ky moment tregon pjesë nga puna ime për të lehtësuar vështirësitë në familje dhe përgjegjësitë e mia universitare”.

Uka Albulena



“Motra ime e vogël, Albulena, po studionte për nivelin Master në Fakultetin Juridik në Ghent, një qytet i mbushur me njerëz, i bukur dhe dinamik, me rreth 250 mijë banorë dhe 1.3 milion vizitorë. Për shkak të COVID-19, ajo u mbyll në dhomën e saj krejt e vetme, por i duhej të jepte edhe pesë provime dhe punimin e Masterit që të diplomahej. Meqenëse kjo ishte hera e parë që ajo jetonte larg familjes, ne e inkurajua të kthehej në shtëpi, pasi që pamë që situata po përkeqësohej, ama duke qenë një grua e fortë, Albulena nuk u tërhoq, por vendosi të qëndronte në Belgjikë.

Ajo na tregoi se ndihej tepër e vetmuar, sepse kishte parë vetëm rreth dhjetë persona në tre muaj, kryesisht punëtorë të supermarketeve ku merrte ushqime. Ajo ishte trishtuar që filmi i saj i preferuar “Unë jam legjendë” u bë pothuajse realiteti i saj. Por ajo vazhdoi të studionte edhe më fort dhe i dha të gjitha provimet dhe e dorëzoi në kohë punimin e saj të Masterit. Albulena diplomoi me notat më të larta dhe u zgjodh mes 3



studentëve kryesues të Universitetit të Ghent-it. Në foto, ajo po feston diplomën e saj para ndërtesës së Universitetit në Ghent, Belgjikë.

Albulena është prova më e mirë se as pandemia nuk mund t'i ndalojë gratë që të arrijnë qëllimet e tyre”.

Arbresh.info

Duke parë urgjencën për raportim në kohë reale të zhvillimeve në lidhje me pandeminë COVID-19 qysh në fillim, portali arbresh.info formoi rubrikën e veçantë “Covid-19”, përmes së cilës transmeton informacione nga vendi, rajoni e bota në lidhje me përballjen me koronavirusin.

Një staf prej 30 personave, 20 prej tyre femra u angazhuam në hartimin dhe ndjekjen e një strategjie për raportim sa më profesional. Fillimisht në lidhje me kapacitetet e Kosovës për përballje, më pas mbulimin nga institucionet që tashmë po merreshin me identifikimin dhe trajtimin e rasteve, e tash dhe me pasojat në sektorë të ndryshëm.

Në kohën e “mbylljes” pothuajse totale, për rreth tre muaj portali arbresh.info ka angazhuar stafin me ndërrime në terren dhe punë nga shtëpia.

Pas “relaksimit” të masave, stafi u kthye në zyrë, duke patur hapësirën e mjaftueshme për distancë. Nuk është bërë dhe as nuk është menduar reduktimi i stafit, dhe pagat janë realizuar normalisht, pavarësisht vonesave të Qeverisë në ndihmë bizneseve, në këtë kohë kur vazhdojmë të kemi probleme me mbledhjen e pagesave nga kompanitë që reklamojnë në portalin arbresh.info.

Furnizimi me maska, dezinfektues qysh nga fillimi i pandemisë nuk ka munguar, derisa pastrimi i zyrave

është bërë rregullisht, sikur edhe disa herë dezinfektimi i tyre.

Meqë puna e secilës ka qenë mjaftë e rëndësishme, portali ka zgjedhur të nominojë të gjithë stafin e gjinisë femërore, në nderim të angazhimit të tyre për të mbajtur të informuar qytetarët, pavarësisht rrethanave të jashtëzakonshme.

Gazetarët:

- | | |
|------------------------|----------------------|
| 1. Albinë Bajraktari | 2. Albinë Haliti |
| 3. Arditë Shkodra | 4. Arditë Zeka |
| 5. Agnesë Çitaku | 6. Elmedinë Ballazhi |
| 7. Elona Haxhiu | 8. Elvinë Sefiu |
| 9. Fitore Hajdari | 10. Gita Lushi |
| 11. Miradije Avdimetaj | 12. Razije Rexhepi |
| 13. Trina Galanxhi | 14. Vlora Selimi |
| 15. Xheneta Pacolli | |

Administrata që ka ndihmuar shumë në lidhje me dokumentacionet e nevojshme për qarkullim, mbulim të nevojave higjienike dhe çështje tjera administrative.

- | | |
|---------------------|------------------------|
| 1. Edona Llumnica | 2. Vjosa Sylaj Borovci |
| 3. Leunora Krasniqi | 4. Gentiana Dakaj |
| 5. Albina Vucetaj | |



Arta

Ibishi Çitaku



"Fatmirësisht unë me familjen time e kemi shijuar çdo ditë izolimi. Ambientimi me rregullin e ri nuk na solli vështirësi. I jam mirënjohëse Zotit për shëndetin e plotë dhe shumë mirë e shfrytëzuam atë periudhë. Një gjendje me rëndësi për të gjithë është shëndeti mental kolektiv i cili në shumë dimensione ka qenë i prekur, por shpresoj që do të rimëkëmbemi bashkë, duke e përkrahur njëri tjetrin.

Për mua personalisht biçikleta është një dhuratë e cila ma mundëson ta shijoj lirinë dhe do t'i ftoj të gjithë ta fillojnë praktikimin e çiklizmit.

Uroj shëndet e mbarësi për të gjithë. Ja kalofshim mbarë me shëndet të plotë!"



Sadrja Bardha

“Ne kemi menduar që gjatë kësaj periudhe izolimi të mbajmë trajnime online falas për të gjitha gratë dhe vajzat që janë të interesuara të marrin pjesë në trajnime, për zhvillimin e bizneseve dhe fuqizimin e tyre. Kemi nisur edhe me trajnimin online për rrobaqepësi”.





"Mes gjithë këtij kaosi, në jetë solla një djalë. Po, po, u bëra nënë në moshën 20-vjeçare. Pas një lindje të vështirë dhe një shërimi të gjatë, më në fund fillova të shijoj hijeshitë e mëmësisë që u bënë kaosi im i preferuar".



Brankica Timotijević


"Si dikush që i pëlqen të udhëtojë, vendosa të aplikoja për një shkëmbim në Portugali, por që atje nuk do shkoja në fakultet në mënyrë klasike, por do të bëja një praktikë. Ata më pranuan dhe shkova në fillim të shkurtit, kur pandemia ende nuk kishte bërë shumë bujë në publik.

Deri nga mesi i marsit po shijoja jetën në Porto, duke takuar njerëz të rinj nga e gjithë bota dhe duke shëtitur qytetin. Kur gjendja e jashtëzakonshme nga mesi i marsit filloi në Portugali, nuk kishte kufizime në lëvizje, kështu që unë pasi i mbaroja obligimet e mia rreth fakultetit dhe shkrimit të provimit të diplomës, e shfrytëzoja kohën për shëtitje të gjata buzë detit dhe në ajër të pastër. Koha kalonte më ngadalë se zakonisht, por obligimet në lidhje me provimin e diplomës, raportin nga praktika, si dhe mbajtja e praktikës në fakultetin në Porto, bënë që gjithçka të shkonte më lehtë, përderisa kishte edhe përgatitje të banesës dhe ushqimit.



Pandemia çrregulloi shumë gjëra, në lidhje me fakultetin, qëndrimin tim në Portugali, kthimin në shtëpi që u kthye në një aventurë të vogël të vërtetë prej dy ditësh udhëtimi. Por gjithçka shkoi mirë, edhe pse të gjithë ishim të frikësuar, arrita mirë në shtëpi dhe u diplomova në fund të qershorit, që ishte një nga ngjarjet më të mira gjatë pandemisë dhe gjendjes së jashtëzakonshme".

Kraja Erмира



“Në foto jam unë me nënën e cila vuan nga kanceri. Lutja ime atë ditë prilli ishte që të jetë vit i bardhë sikur kjo borë që ra, sepse krahas stresit të pandemisë ne kemi vuajtur shumë dhe kemi hequr shumë. Po atë kohë kemi pasur me ia ba nanës një incizim CT, tumormarker dhe po në atë periudhë gjithçka ishte e mbyllur, çdo minutë të jetës në pandemi kam menduar që nana do të më vdiste nga mungesa e kurimit”

“Në foton e dytë e njëjta brengë, por me masa pak më të liruara, shpresa për jetë na u kthye. Mbas shumë angazhimeve e mundimeve arritëm të paktën ta shohim nënën të buzëqeshur”

“Nëna gjatë pandemisë e mori një cikël të kimios, u lodh shumë. Rruzat e kuqe të gjakut bajagi ranë, dhe ne shkuam në Prevallë për disa ditë deri sa nëna ta merrte veten. Si familje e kemi përjetuar shumë keq situatën”



Gentiana Pallaska



Një ditë në karantinë

“Nëna ende zgjohet para orës 7 të mëngjesit. Bota ka ngecur, koha është më pak e perceptueshme se kurrë më parë, megjithatë Nëna ende zgjohet para orës 7 të mëngjesit.



Nëna bën çaj në mëngjes, fillon punën e saj me të shpejtë dhe pret të zgjohemi ne të tjerët. Qyteti vazhdon të heshtë siç nuk e ka zakon, zogj shfaqen aty këtu, kurse ne shohim gjethet si çelin dhe formohen, dhe botët tona të brendshme bëhen njësh duke i kaluar të gjitha orët së bashku, të gjithë këtu, duke ndihmuar, punuar, mësuar dhe ri-mësuar të duam dhe të na duan. Babai zgjohet pak më vonë, punon shumë dhe bën shaka, dhe të duket sikur koha, dikur një mall i çmuar, tani është çuditërisht e bollshme.

Nëna gatuan mëngjesin, drekën, darkën, dhe na mban gjallë me sytë e mbushur me dashuri dhe zemrën e qetë për kohën që na bie ta kalojmë së bashku. Kohët e COVID-19, edhe pse stresuese, të çuditshme dhe rraskapitëse, prapëseprapë e ngadalësuan orën, dhe i bënë njerëzit të reflektonin, siç bëmë ne këtu në tryezën e ngrënies, të kthyer në një ishull të vogël të gjithçkaje të rëndësishme, të çmuar dhe të pafundme”.

Tregimi për nënën e saj

“Kur filloi karantina, unë mbeta vetëm në banesën time në Prishtinë nga e cila punoja, dhe dilja vetëm një herë në javë për të blerë ushqime. Një pjesë e familjes sime jeton në Prizren, kurse vëllai im mjek dhe gruaja e tij jetojnë në Turqi. Njëra nga motrat e mia punon në një barnatore, që do të thotë se është punëtore esenciale që punon gjatë gjithë kohës. Video telefonatat ishin mënyra jonë e komunikimit për më shumë se dy muaj. Më mungonte aq shumë pitja e shtëpisë, por nuk guxoja të hyja në furra buke dhe të blija byrek.

Herën e parë që shkova në Prizren, nëna ime bëri piten më të shijshme që kam provuar ndonjëherë. Ajo gjithashtu kujdesej që gjithmonë të kishte ushqimin e duhur për të ruajtur imunitetin e motrës sime, e cila është potencialisht e ekspozuar ndaj personave të infektuar që vijnë

të blejnë barna. Karantina na afroi më shumë dhe na tregoi se ruajtja e lidhjes me familjen, edhe pse jo fizikisht, është gjëja më e rëndësishme, dhe se ribashkimi është shumë i shtrenjtë.

Të tregosh dashuri nuk është vetëm ta thuash me fjalë, por edhe me veprime dhe gjeste të vogla, përfshirë edhe të qenit të përgjegjshëm dhe respektimin e masave të mbrojtjes. Kjo nënkupton se jeni duke u kujdesur dhe menduar për njerëzit më të dashur. E vlerësojmë çdo moment që kalojmë së bashku, dhe ndërkohë mbajmë lidhje nga distanca”.



Shyhnrete

Kadriu




Tregimi për nënë Fahrije

“Kjo është Nëna Fahrije. Një fytyrë e plakur dhe e lodhur, nuk e ka lodhur pandemia por mërzia. Ajo ka humbur bashkëshortin e saj Ajferin pikërisht nga virusi COVID 19, më 16 korrik 2020. Tani historia e saj e jetës është më ndryshe, sepse nuk e ka pjesën që e shoqëroi për 37 vite.

Gjatë tërë jetës së tij, burri i Fahrijes punoi në këtë market, marketin ‘Besiana’. Tani, Nëna Fahrije po i pret konsumatorët duke respektuar masat, dhe duke u bërë e fortë e duke vazhduar rrugën që e la bashkëshorti.. të mbajë familjen me të hyrat e marketit dhe të kujdeset edhe për të tjerët. Ajo po mundohet t’i mirëpres konsumatorët ashtu siç bënte Ajferi, me plot dashuri e respekt.

Nënë Fahrije, virusi COVID-19 e la të vetme në shtratin e saj. Por Ajra, vajza ime, ka vendosur që të mos e lë gjyshen vet. Tani po lexojnë diçka, para se Ajra t’i mbyllë sytë e të ëndërrojë një botë plot me ngjyra, e Nëna Fahrije të ëndërrojë takimin me bashkëshortin që aq shumë e deshti, në botën tjetër...”



Andrejeviq Sunçica



"S'jam për fotografi". Për secilën foto reagimi ishte i njëjtë. Kjo është arsyeja pse protagonistja në foto pothuajse asnjëherë nuk duket spontane. Dhe nuk është spontane. Fotografimi për të është i mërzitshëm, por beson se disa situata duhet dhe është mirë të dokumentohen.

Fotografitë e përzgjedhura për këtë garë ia tregova edhe mikeshës sime nga fotografitë. Biseduam se si mund t'i përshkruaj ato.

Çfarë ka ndryshuar – e pyeta.

Përgjigja ishte – gjithëcka.

"Duke u nisur nga fakti që kemi kaluar dy muaj e gjysmë brenda banesave, shtëpive tona... Dikush do të thotë se nuk është edhe aq e tmerrshme. Por është e vështirë kur e dini që nuk mund të bëni diçka, se është e ndaluar dhe pyesni veten – po ata që nuk kanë të ardhura, po ata që jetojnë me ndihmë sociale, si mbijetojnë? Shtoni kësaj edhe lajmet. Çdo ditë numri i të infektuarve, të vdekurve ... Çdo ditë. E si rrjedhojë edhe frika e përditshme", shpjegoi ajo.

Ajo beson se pasojat e "një normaliteti të ri" dhe këmbëngulja e vazhdueshme për një distancë "sociale", dhe jo fizike, do të jenë të dukshme.

Muaj të tërë të introspeksionit, qoftë përmes leximit të librave, vëzhgimit



të të tjerëve, apo vetvetes – janë pikërisht këto të paraqitura në fotografi. Vështirimi i gjatë në vetvete nuk mund të kënaqë askënd me të vërtetë. Mbase kjo është arsyeja pse protagonistja e fotos nuk është spontane".

Enis Puka



Tregimi për Teuta Gashin

“Kjo është Teuta Gashi, gazetare në Kosovë. Gjatë kohës së izolimit, ajo dhe shumë kolege të saj kanë punuar pa ndërprerë. Ato kanë qenë të rrezikuara dhe kanë rrezikuar edhe të tjerët, por gjithë kjo që të informojnë dhe të mbajnë energjinë pozitive të të gjithë.

Gazetaria është profesion, sfidë edhe në situata normale, por gjatë izolimit

ka qenë përveç këtyre edhe përballje me një gjendje të rëndë dhe të pa praktikuar më herët.

Në foto shihet Teuta duke realizuar disa nga punët e saj në terren, duke realizuar intervista me njerëz (emisione dhe dokumentare). Pavarësisht situatës dhe rrezikut, këto projekte kanë rezultuar në sukses, duke respektuar gjithmonë masat e caktuara nga shteti.

Teuta e gratë e profesionit të saj, kanë qenë në radhën e parë në luftë me pandeminë vetëm e vetëm që qytetarët të cilët kanë qenë nëpër shtëpitë e tyre të njohin dhe mbrohen nga Covid-19. Gazetaret, përveç punës profesionale kanë pasur punë edhe në shtëpi për familjet e tyre, për të ndihmuar familjarët në aspektin mendor, aspektin financiar por edhe në përkujdesje”.



Musa Ardiana

Tregimi për Xhyla Hazirin

"Kjo është Tezja Xhylë (Xhyla Haziri), gruaja më punëtore që kam njohur. Ajo me profesion është rrobaqepëse dhe sekretare në Zyrën për Personat e Pagjetur në Mitrovicë.

Duke parë gjendjen ekonomike në shoqërinë tonë, e rënduar veçanërisht gjatë pandemisë, kur edhe vendosja e maskës ka qenë obligative, tezja ime filloi të punojë maska falas për të gjithë qytetarët që nuk kishin mundësi financiare t'i siguronin për vete dhe për familjarët e tyre. Kjo iniciativë e saj bëri që edhe shumë gra si ajo t'i bashkohen më pas dhe ta ndihmojnë secila në mënyrën e vet në arritjen e këtij qëllimi.



Ajo gjithë këtë punë e ka filluar vullnetarisht dhe me të gjitha materialet shpenzuese të vetat. Deri tani ka arritur t'i qepë rreth 1700 maska dhe që të gjitha janë shpërndarë te qytetarët. E gjithë kjo më ka bërë të mendoj se jo çdo punë që bëhet duhet bërë për përfitime financiare.

Ajo ka inspiruar shumë gra të tjera dhe ka treguar se një grua e fortë jo vetëm që mund t'ia dalë e vetme por edhe mund t'iu ndihmojë të tjerëve dhe të ndikojë në zhvillimin e shoqërisë".



OJQ Zensko Pravo

(Të drejtat e grave)



“Fotografia paraqet një nënë dhe një djalë të mitur që takohen pas 37 ditësh ndarje gjatë karantinës së COVID-19.

Fëmija kishte shkuar të vizitonte familjen e tij në Serbi kur u mbyllën kufijtë dhe u vendos karantina e detyrueshme në Qendrën e Studentëve në Prishtinë. Pas 34 ditësh përpjekje për të gjetur zgjidhje për t’u ribashkuar me djalin e saj, Dragana Rashiq, nëna e fëmijës dhe e mbijetuar e dhunës në familje, iu referua OJQ-së për të Drejtat e Grave në Mitrovicën e Veriut nga zyrtari policor në të njëjtin qytet për shkak të kompleksitetit të çështjes. Me ta dëgjuar rastin, Tijana Simic LaValley nga organizata kontaktoi autoritetet përgjegjëse, si dhe gra në pozita vendimmarrëse, për të ndihmuar në zgjidhjen e problemit.

Mes tyre ishte kolonele Afërdita Mikullovc, komandante e Stacionit Policor të Mitrovicës së Jugut. Përmes bashkëpunimit efikas me kolonele Mikullovcin dhe pas përgjigjes së shpejtë nga Qendra Operative e Ministrisë së Punëve të Brendshme, nëna dhe fëmija u ribashkuan në pikëkalimin kufitar të Jarinjës pas 37 ditësh.

Ky tregim është një shembull i shkëlqyeshëm se sa jetike janë organizatat e drejtuara nga gratë, gratë në pozita vendimmarrëse, si dhe bashkëpunimi mes OJQ-ve dhe institucioneve. Në momentin e ribashkimit, si policët kosovarë ashtu edhe ata serbë gati u përlo të, duke i uruar djalit të mos prekej nga Covid-19 dhe t’ia kalonte mirë me nënën e tij”.

GRA TË TJERA TË JASHTËZAKONSHME GJATË PANDEMISË

...të cilat nuk ishin
pjesë e garës,
por veprimet e të cilave
gjatë pandemisë janë
shembull i mirë për
nismat dhe leadershipin
e grave.



Elza Ramadani

...dhe si kafshët endacake nuk u harruan gjatë pandemisë

“Pandemia dhe karantinimi (izolimi i qytetarëve) kanë sjellur shumë ndryshime në jetën e njerëzve por dukshëm edhe në jetën e kafshëve shoqëruese, e sidomos të atyre endacake në Kosovë.

Gjatë fillimit të karantinimit për shkak të koronavirusit, kafshët endacake në Kosovë kishin mangësi për t’u ushqyer, ngaqë mbetje te restoraneve nuk kishte dhe as njerëz nuk kishte në rrugë për t’i ushqyer ato. Shumë aktivistë dhe fabrika e prodhimit të ushqimit “Poppins” (e cila ka dhuruar qindra kilogram ushqim për kafshë), janë organizuar dhe kanë ushqyer qentë dhe macet e rrugës.

Në kuadër të organizatës që përfaqësoj (Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve) kemi bërë shumë përpjeke që së bashku me disa vullnetarë, t’i ushqejmë kafshët në rrugë; kemi bërë kërkesën në MPB



(Ministrinë e Punëve të Brendshme) për t’iu dhënë një numri të aktivistëve leje për qarkullim, në mënyrë që të dalin në çfarëdo kohe për t’u kujdesur për kafshët e rrugës.

Çfarë është po ashtu shumë me rëndësi, gjatë kohës së pandemisë, organizata ka arritur që t’i shpëtojë disa qen të cilët ishin të mbajtur për luftëra dhe po ashtu kemi bërë vizita inspektuese në projektin shtetëror të kastrimit dhe sterilizimit të qenve në gjithë Republikën e Kosovës i cili projekt ishte i menaxhuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Vlen të theksohet se organizata të cilën e udhëheqi, ka lansuar një fushatë vetëdijësuese për kafshët shoqëruese dhe COVID-19, ngaqë në Kosovë (dhe në disa vende të botës) ishte keqkuptuar se kafshët shoqëruese, mund ta bartin koronavirusin. Natyrisht se kjo nuk ishte e vërtetë (e vërtetuar nga OBSH) dhe me fushatën tonë vetëdijësuese, kemi arritur që sado pak të evitojmë braktisje të shumta të kafshëve shoqëruese në rrugë”.

...dhe sa të rëndësishëm janë zërat e aktivizimit gjatë kohërave të vështira

"Gjatë kohës së pandemisë, qeveritë në mbarë botën morën masa që të mbrojnë dhe mbështesin qytetarët e tyre në këtë kohë shumë të vështirë për njerëzimin, por fatkeqësisht në Kosovë na u desh të përballemi me një padrejtësi tjetër. Ne përjetuam rënien e qeverisë në kohë pandemie..

Më është dashur ta ngre zërin njëfarësoj, sepse ne qytetarët votuam për ndryshim dhe tani po manipuloheshim. Duke ua lidhur sytë statujave të heronjve tanë, doja të shprehja zemërimin dhe zhgënjimin tonë me realitetin. Sidoqoftë, gruaja më e votuar në historinë tonë si kandidate për Kryeministër u hoq nga një mashkull patriarkal. Edhe sa kohë duhet që ne gratë të na heqin dhe të na mohohen të drejtat tona të barabarta në këtë vend?

Gjatë pandemisë, Ujëvarat dhe Parku i Mirushës u shkatërruan nga një projekt nga komuna e Klinës. Pa leje mjedisore dhe pa dëgjim publik, u bë një ndërtim në një monument të natyrës të mbrojtur ndërkombëtarisht nga Unioni Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës (IUCN).

Aktivizmi im gjatë pandemisë është shpresë për ndryshim dhe liri të shprehjes, dhe nëse qëndrojmë të bashkuar mund të ngremë shumë çështje dhe t'i ndryshojmë ato, sepse nuk është e lehtë të merresh



me çështje të tilla në këto kohëra të vështira.

Unë jam një nënë vetëushqyese me një punë me orar të plotë që siguron ushqimin dhe një kulm mbi ne, dhe mbajtja e të gjitha detyrave familjare mbi supë, duke mos hequr dorë nga aktivizmi në të njëjtën kohë, është i vështirë emocionalisht.

Nuk e kam në plan të heq dorë, dhe për sa kohë që jetoj këtu do të ma dëgjoni hungërimin prej luaneshe".

Mrika Nikqi



**...dhesi gruaja më e re në botë
që u ngjit në Shtatë Majat më
të arta e ri-gjeti veten për t'u
mbajtur në formë**

“Nuk mund të themi që dita është e zakonshme në karantinë, por ja që çdoherë kur biem në situata të ndryshme gjatë jetës, mundohemi të përshtatemi.

Edhe për mua, prej një situatë komplet ndryshe nga një vit më parë – gjatë të cilit, së bashku me babin tim



ngjita majat më të larta të shtatë kontinenteve, me ditët e mbushura përplot me aktivitet, mund e sakrificë, pandemia më solli ditët me kohë të bollshme, por jo edhe me aq mundësi të vazhdimit të ngjitjes së maleve të reja ashtu siç kisha planifikuar.

Duke parë se pandemisë nuk i shihej fundi, atëherë me ngadalë vazhdova aktivitetet brenda mundësive që rekomandoheshin nga IKSHKP. Çdo mëngjes, siç edhe bëj çdoherë pavarësisht situatës pandemike në të cilën gjendemi, në shtëpi bëj ushtrimet e zgjatjeve, të cilat i aplikoj rreth një orë. Pastaj vazhdoj me obligimet që kam rreth studimeve dhe vazhdoj të kryej punë të cilat duhet kryer gjatë ditës. Kam punuar shumë në planifikimin e realizimit të qëllimeve dhe planeve për të ardhmen, jam kujdesur më shumë se kurrë për shëndetin tim fizik, dhe atë psikik.

Ushqimi i shëndetshëm dhe ushtrimi fizik ishin pjesë e rutinës time si çdoherë. Gjithashtu ishte koha e duhur për ta shfrytëzuar maksimalisht me familjen time”.

Dr. Donjeta Pllana, Dr. Pranvera Abazi dhe Dr. Zana Kaçaniku

...dhe si tri gra menaxhuan testimin në Laboratorin e Diagnostikimit Molekular

“Fillimi i vitit 2020 na zuri duke ndjekur përhapjen e virusit përgjatë shteteve të ndryshme dhe pamjet e frikshme në media, derisa shpresonim që nuk do ta përfetojmë edhe ne të njëjtën situatë.

Edhe pse kemi ndjekur specializime në vende të ndryshme duke përfshirë edhe Kosovën, për ne ishte një përvojë e re, që nga muaji shkurt kur filluam të testojmë mostrat e para të dyshimta në SARS CoV-2, me virus të panjohur deri atëherë.

Me rritjen e kërkesës për testim u mobilizua me kapacitetet e pakta në dispononim me qëllimin e vetëm, testimin e të gjitha mostrave që vinin në laboratorin për diagnostikim molekular, në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Puna në laborator është jashtëzakonisht e lodhshme për mikrobiologë, e këtë e rëndonte edhe më shumë aparatura specifike, stafi i reduktuar, orari i stërzgjtur, mënyra e punës me pajisje shtesë mbrojtëse, dhe të tjera.

Përgjegjësia që kishim ishte shumë më e madhe se frika, stresi dhe puna e pandalshme. Me pak gjumë, ushqim



jo të rregullt, stil tjetër të jetës por me vullnet për t'i ofruar ndihme dhe për të kontribuar për vendin tonë, qëllimi kryesor i yni ishte ofrimi i rezultateve sa më të shpejta në testim për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim”.



...dhe iniciativa e saj për t'i mbështetur bizneset e udhëhequra nga gratë që janë prekur nga Covid-19

Si në çdo aspekt tjetër, gjatë pandemisë së COVID-19, gratë në biznes janë prekur në një mënyrë më ndryshe në krahasim me burrat. Deputetja Mimoza Kusari ka një traditë të gjatë të luftës për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore, në veçanti për të drejtat e grave në vendin e punës. Ishte ajo që në legjislaturën e mëparshme propozoi kuotën gjinore për gratë në bordet e korporatave, duke përfshirë shoqëritë aksionare. Ajo e bëri këtë kundrejt rezistencës nga shumë, duke përfshirë përfaqësuesit politikë dhe disa brenda komunitetit të biznesit. Megjithatë, ajo arriti të angazhojë deputete të tjera dhe të bindë Kuvendin.

Ishte e qartë se gjatë pandemisë ajo nuk do të rrinte duarkryq. Duke njohur situatën nga e cila u prekën shumë biznese të grave, ajo e përqendroi energjinë e saj në përpjekjen për të bërë çmos për të ndihmuar. Si anëtare

e Komisionit Parlamentar për Buxhetin në kuadër të Kuvendit të Kosovës dhe e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, ajo pati idenë largpamëse për t'i propozuar Kuvendit krijimin e një kodi specifik buxhetor të dedikuar për të ndihmuar bizneset që zotërohen ose udhëhiqen nga gratë, biznese këto që u prekën nga kriza ekonomike si pasojë e COVID-19. Këto përpjekje nënkuptuan nevojën për ta dërguar propozimin prapa për rishikim ose për ta hedhur atë në rivotim. Ajo kishte aleatë të shquar, si kryetarja e Kuvendit dhe deputetet tjera, të cilat ndihmuan për të bindur grupet e ndryshme politike. Ajo madje duhej të justifikonte iniciativën duke e krahasuar me shpenzime të tjera, të tilla si ato të dedikuara për mbrojtjen, që deputetët e tjerë të kuptonin se propozimi i saj ishte i arsyeshëm dhe proporcional: që ndihma përmes skemës së granteve të parashikuara për rimëkëmbjen ekonomike gjatë pandemisë së COVID-19 do të arrinte në mënyrë të barabartë sipërmarrësit burra dhe gra. Përfundimisht, iniciativa u miratua nga Kuvendi me një shumicë të sigurt ndërpartiake, e cila përfshinte përfaqësuesit e shumicës së komuniteteve të pakicave.

Masa e propozuar do të zbatohet jo vetëm për këtë vit, por edhe për të ardhmen, meqë kodi specifik buxhetor do të qëndrojë për vitet vijuese buxhetore. Në kuptim praktik, në buxhetin për vitin 2021, në kuadër të skemës së granteve prej 1 milion euro, një shumë prej të paktën 400.000 euro është paraparë me synim për bizneset e drejtuara nga gratë. Për



më tepër, debati në Kuvend dhe argumentet e dhëna gjatë debatit ndihmuan që qeveria më të mos ketë frikë për të folur për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore. Iniciativa e znj. Kusari bëri që qeveria e Kosovës të ndërmarrë edhe një masë tjetër të avancuar. Në tetor 2020, me iniciativën e Agjencisë për Barazi Gjinore, qeveria e Kosovës miratoi planin për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, i cili parashikon ndarjen e 2 milionë eurove për të adresuar dimensionin gjinor të sfidave të krijuara nga COVID-19.

Fakti është se masat afirmative në dobi të atyre që janë më pak të

përfaqësuar, që përgjithësisht janë gra, nuk janë gjithmonë të lehta për t'u kuptuar. Ato kurrë nuk shihen si prioritet. Fitohet përshtypja se pothuaj kurrë nuk vjen momenti i duhur për to. Siç thotë znj. Kusari, në politikë 'Nëse pritni momentin e duhur për të bërë ndryshime, ndryshimi nuk do të ndodhë kurrë. Ndryshimi dhemb, edhe nëse është për të mirë, sepse përgjithësisht njerëzve u pëlqen gjendja *status quo* dhe ata nuk duan të përfshihen në ndryshime'. Por, kjo krizë e COVID-19 na ka ndihmuar të kuptojmë se edhe në kohë të pasigurisë, gjithmonë ka vend për ndryshim për të mirë.

Strehimoret për dhunën në familje dhe mbi bazë gjinore në Kosovë

...dhe si operuan ato pa ndërprerje për pranimin dhe mbështetjen të mbijetuarave gjatë pandemisë

Vlerësimet e shpejta në mbarë botën treguan se viktimat e dhunës në familje dhe me bazë gjinore do të prekeshin në mënyrë specifike gjatë Covid-19. Masat e vendosura nga qeveria e Kosovës përfshinë edhe një periudhë karantine nga 12 marsi deri më 31 maj. Kjo nënkuptoi që shumë gra do të gjendeshin të mbyllura me abuzuesit e tyre. Izolimi dhe varësia financiare mund ta rrisnin pushtetin dhe kontrollin e kryesit, dhe ekzistonte frika se mund të rritej numri i rasteve fatale.



Qeveria e Kosovës tregoi një shkallë jetike të angazhimit. Më 15 prill, viktimat e dhunës u përjashtuan nga kufizimi i lëvizjes i vendosur nga qeveria. Sidoqoftë, Agjencia për Barazi Gjinore, Organizatat e Shoqërisë Civile të Grave dhe organizatat ndërkombëtare,

përfshirë EULEX-in, ngritën shqetësime rreth vështirësive të mundshme që viktimat t'i raportonin rastet, dhe për cilësinë e funksionimit të sistemit të rregullt të mbrojtjes gjatë karantinës.



Si përgjigje ndaj këtyre shqetësimeve, më 24 prill 2020, Ministria e Shëndetësisë nxorri një Qarkore Informative për krijimin e një hapësire të dedikuar brenda 'Qendrës së Studentëve' të Universitetit të Prishtinës, ku viktimat e dhunës në familje dhe me bazë gjinore mund të karantinoheshin para se të dërgoheshin në strehimore të rregullta. Strehimorja e përkohshme ka funksionuar që prej asaj kohe. Viktimat strehohen atje dhe nuk dërgohen në strehimoret e rregullta pa u siguruar se nuk kanë Covid-19. Ato marrin shërbime të rregullta nga Zyra e Avokimit për Viktimat dhe Qendra për Mirëqenie Sociale. Rrjeti i Grave të Kosovës koordinon qasjen në shërbime, përfshirë ndihmën psikologjike dhe juridike. Më vonë, qarkorja kaloi në plotësim-ndryshim, dhe viktimave nga komunitetet jo-shumicë iu dha mundësia të strehohen në Qendrën Përfshirëse të Grave në Novobërdë, nëse aty ndihen më komode.

Ekipi redaktorial



Autorë:

Arbër Selmani, Ylli Tafarshiku
Shtëpia e Evropës

Kontribues:

Reyes Charles Cuellar, Maria
Berishaj-Sylejmani
Përfaqësues i posaçëm i BE-së

Redaktorë:

Erëza Vela, Vedat Shehu
Shtëpia e Evropës

Dizajn:

Genta Shabani
Shtëpia e Evropës



GRATË DHE COVID-19 TREGIMET QË KANË RËNDËSI



Njohja e sfidave të grave
gjatë pandemisë
Covid-19!



European
Union
Kosovo



EUROPE
HOUSE